



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri
Website: www.amshc.gov.al E-mail: info@amshc.gov.al

"MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA"

Shkurt 2015

Përsëritje,

A besoni në solidaritetin e shqiptarëve?

Të gjithë ishim dëshmitarë të egërsisë së natyrës me rreshjet që mbuluan jugun e Shqipërisë në fund të muajit Janar 2015 dhe fillim të muajit Shkurt 2015.

Fatkeqësisht, shumë shqiptarë i përjetuan në kurrizin e tyre përmbytjet dhe dëmtimet që u shkaktuan si pasojë e rreshjeve të dendura papushim. Qindra familje dhe mijëra qytetarë u detyruan të braktisnin shtëpitë e tyre dhe gjithçka tjetër të zaptuara nga ujrat e rrëmbëshme.

Të tjerë ndjenë domosdoshmërinë e solidaritetit në mbështetje të bashkëqytetarëve, të cilët jo vetëm kishin humbur gjithçka, por gjendeshin edhe në vështirësi të madhe për mjete bazike.

Pikërisht, në kuadër të emergjencës civile, si edhe në përmbushje të misionit të saj, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi nismat:

"Në ndihmë të zonave të përmbytura!" dhe
"Një kilogram për emergjencën!"

Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë me anën e një kontributi simbolik, (duke dhuruar pagesat e përcaktuara për mbledhjet e tij) krijoi premisat për fillimin e kësaj fushate solidariteti të shoqërisë civile me zonat e nënshtruara nga forcat e natyrës.



Ftesës së AMSHC-së, drejtuar gjithë Organizatatve Jo-Fitimprurëse, Fondacioneve, si dhe të gjithë aktorëve të tjerë të shoqërisë civile për t'iu bashkuar këtij momenti, për të ndihmuar dhe lehtësuar familjet që ndodhen në kushte ekstreme jetese, me kontribute si: batanije, ushqime, veshmbathje, punë vullnetare, si dhe me gjithçka tjetër që mund t'u nevojitej njerëzve dhe familjeve të prekura, iu përgjigjën në një kohë shumë të shpejtë Organizata, Insitucione dhe qytetarë nga Tirana dhe nga rrethe të tjera të vendit.

Ju falenderojmë!

Fletushka e fushatës “1 kg për emergjencën”
e shpërndarë pranë supermarketeve **Conad** dhe **Eco Market** si dhe në hipermarketin **Carrefour**

"1 kg për emergjencën"

NË KËTË SUPERMARKET

Mund ta bësh pazarin për atë që nuk mundet!

Ndihmë për popullsinë e zonave të Jugut
që aktualisht ndodhen nën ujë,
të nënshtruara nga forca e natyrës,
e që po përjetojnë kushte ekstreme jetese

7 – 8 shkurt 2015

me nismën e



Në bashkëpunim me



Banka Shqiptare e Ushqimit



Artikujt që mund të dhurohen:

- *Miell*
- *Sheqer*
- *Makarona*
- *Oriz*
- *Salcë domatesh në kuti metalike*
- *Biskota*
- *Fasule në kuti metalike*
- *Vaj në shishe plastike*
- *Kripë*
- *Konserva peshku*
- *Konserva mishi*
- *Reçel në kuti metalike*
- *Sapun*

Kontakt

Cel. 06962 70355

Cel. 06821 44189

"MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA"

Shkurt 2015

Organizata “Përtej Barrierave”



Vullnetarët e Organizatës “Përtej Barrierave” me shumë përkushtim dhe me një punë të pa lodhur iu përgjigjën thirrjes së lëshuar nga AMSHC-ja për të grumbulluar ndihmat në ushqime veshmbathje etj. Me ushqimet e mbledhura nga vullnetarët e kësaj Organizate u përgatitën 54 pako në përputhje me kërkesën dhe standardin e kërkuar nga Shtabi i Emergjencave Civile.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) koordinoi punën për dërgesën e këtij kontigjenti ndihmash drejt zonave të përmbytura.

AMSHC falenderon Organizatën “Përtej Barrierave”, vullnetarët e saj për punën e jashtëzakonshme që ata bënë për të lehtësuar sado pak jetën e banorëve të përmbytur.

Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të ardhmen"

Ndihma të ofruara nga Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të ardhmen" në ndihmë të zonave të përmbytura, të dorëzuara pranë AMSHC-së.



GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)

Ndihma të ofruara nga GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) në ndihmë të zonave të përmbytura, të dorëzuara pranë AMSHC-së.



Organizata DEV-AID

Iniciativa “1 PAKO 2 DUARI!” e nisur nga organizata DEV-AID, u kurorëzua me ne përgatitjen e 20 paketave ushqimore ku ne perberberje te seciles prej tyre ishin 13 kg ushqime (secila): 3 litra vaj; 3 kg oriz; 4 pako makarona; 3 kg sheqer; 1 pako kripe gjelle; 1 detergjent lares; 4 sapune tualeti. Pevcec paketave ushqimore sa me siper, ne ndihme te 20 familjeve shkojne edhe 17 koli miell (170 kg). Ne bashkepunim me Shtabin e Emergjencave Civile u mundesua transporti dhe koordinimi i veprimeve qe ndihmat te arrijne ne destinacionin perfundimtar, ne dobi te komunitetit ne veshtiresi.



Grupi koordinues për nismën "Një kilogram për emergjencën"



"MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA"

Shkurt 2015



Universiteti "Marin Barleti"



Fondacioni "QERSHI"



Lëvizja "MJAFT"



Qendra EDEN dhe stafi



ORTI Market - Elbasan



Inspektoriati Qendror



Organizata NDIHMË!!!



Universiteti "ALDENT"



"Eco Market" - (Komuna e Parisit)



Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri



Fondacioni "MIRËSIA"




"MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA"

Shkurt 2015



Vullnetarë të organizuar të mbledhin ushqime pranë supermarketeve **Conad** dhe **Eco Market** si dhe hipermarketit **Carrefour** në ndihmë të qytetarëve të zonave të përmbytura në Jug të vendit.



Stafi i Shërbimit Infektiv të QSUT

Ndihma të ofruara nga Stafi i Shërbimit Infektiv të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" (QSUT) në ndihmë të zonave të përmbytura, të dorëzuara pranë AMSHC-së.



Shoqata "Albanian CSR Network"

Shoqata "Albanian CSR Network" në ndihmë për zonat e përmbytura alokoi ndihma në ushqime për 100 familje duke i të dorëzuar pranë ambjenteve të AMSHC-së.



"MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA"

Shkurt 2015



“PËR TY” nga Lori

Shumë prekëse ka qenë letra që shoqëronte një pako ndihmash ushqimesh, në kuadër të nismës “Një kilogram për emergjencën”. Ndërkohë që sytë të mbushen me lot, teksta e lexon, zemra ngrohet nga dashuria dhe mbështetja e madhe që ofrohet vetëm në disa rreshta të sinqertë...


PËR TY

“ Gjej forcën të mos gjunjëzohesh përpara zemërimit të madh të natyrës!

Nuk je vetëm

Bashkë, nga pak, nga aq sa mundemi, çdo herë do ta gjejmë fuqinë për të rifilluar jo domosdoshmërisht nga e para, duke shpresuar dhe duke u përpjekur që për rifillime të tilla, kurrë mos jetë më nevoja!

NGA L. HYSA



“MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA”

Shkurt 2015

Kontributet e grumbulluara në mbështetje të nismës “Një kilogram për emergjencën” u dorëzuan edhe pranë pikës kryesore të grumbullimit dhe shpërndarjes në adresën:

Rruga "Don Bosko", te Kisha Katolike, (YAPS), Tiranë



Tiranë, 12 shkurt 2015

Vullnetarë gjatë ngarkimit të kamionëve me 7 ton ndihma për familjet e përmbytura, përpara nisjes për në Fier



"MË SHUMË SOLIDARITET PËR KË PO HUMBET GJITHÇKA"

Shkurt 2015

NË NDIHMË TË ZONAVE TË PËRMBYTURA

#SOLIDARITET #PËRMBYTJE2015



Nën moton:

“Çdo ndihmë vlen!”

besuam pa kushte tek solidariteti
dhe vetëm brenda një jave
u arrit të mblidheshin mbi 7.4 tonë ndihma



amshc

Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile